Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit

611-26-9425-2-3-6/C988

KONTRATË /SHERBIM

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

PRANUAR		17/11/	20 26
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02	400/01	-494	24

Emri i Projektit: **Mirëmbajtja dhe servisimi i kalldajave për QKMF Drenas,QMF Komoran dhe Tërstenik,AMF Gllanasellë,AMF Nekoc,AMF Baicë,AMF Abri e Epërme**

Numri identifikues: : **611-26-9425-2-3-6 ,Datë: 17.11.2026 ;** Nr. i arkivit;

PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT , përfaqësuar nga **GENTIANA QELA** Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës").

EKOTERMIKA SH.P.K., Rr. Blerim Krasniqi p.n, BUKOSH, 811034834, (ne vazhdim "Ofruesi i përfaqësuar nga **ARLIND KRASNIQI** , Drejtor (më tutje kontraktuese).

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **Mirëmbajtja dhe servisimi i kalldajave për QKMF Drenas,QMF Komoran dhe Tërstenik,AMF Gllanasellë,AMF Nekoc,AMF Baicë,AMF Abri e Epërme**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të shërbimeve do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP[1].
Periudha e kryrjes se punëve/shërbimeve dhe Shërbimeve do të jetë deri në afatin : **10 dite**

Neni 3 Çmimi

3 Çmimi i indikativ do të jetë: **1,333.25€** ndërsa vlera e parashikuar e kontratës është **3,000.00** [***Tre mijë euro]***

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.
Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit te projektit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data

e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Krytari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së **sherbimeve** duhet të jetë brenda **10 dite**. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen DSHMS

se.

a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumetat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **sherbimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **sherbimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumetat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj.Poashtu obligohet që dokumetet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i /**shërbimeve**/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit., dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Krytari i Komunes.

Neni 7 Garancioni i sherbimeve]

7.1 Garancioni nuk kerkohet.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[sherbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f).

Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në në pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me **menjehere pas nenshkrimit. .**

Për Autoritetin Kontraktues		**Për Kontraktuesin**	
Emri:	**GENTIANA QELA**	Emri:	**ARLIND KRASNIQI**
Pozita:	**ZPP**	Pozita:	**DREJTOR**
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.11.2026	Data:	12.11.2026
Vula:		Vula:	EKOTERMIKA SH.P.K. 811034834 Bukosh - Suharekë

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I SISTEMIT TË NGROHJES QENDRORE NË QENDRAT SHËNDETËSORE

e intervenimeve për mirëmbajtjen dhe riparimin e kaldajave me pelet dhe sistemit të ngrohjes, përfshirë sistemin elektrik të kalldave në objektet shëndetësore të Komunës së Drenasit.

TABELA A - SHËRBIMET

Nr.	Përshkrimi i pozicionit dhe specifikimi teknik	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Pështimi në % sipas Rëndësisë	Vlera e pështuar
1	Servisimi i kaldajës me pelet, brenerit, pompave qarkulluese dhe pajisjeve tjera përcjellëse, si dhe rrjetit, për kalldat me kapacitetet përkatëse 30–200 kilovat. Përfshin kontrollimin dhe pastrimin e kaldajës, djegësit, ventilatorëve, mekanizmit të furnizimit me pelet, sistemit të nxjerrjes së tymit, panelit elektrik, sensorëve, termostateve, pompave qarkulluese, enës së zgjerimit, valvulave të sigurisë, tubacioneve dhe elementeve të sistemit të rrjetit. kontrollimin e funksionimit, rregullimet e nevojshme dhe testimin pas servisimit. Çmimi përfshin punën, veglat, materialet shpenzuese për servis dhe pjesët e imta që nuk janë paraparë në këtë paramasë. Pjesët rezervë të zëvendësuara paguhen veçmas sipas pozicioneve përkatëse të paramasës.	copë	1	200	200	50%	225
2	Eliminimi i rrjedhjeve të ujit nga tubacionet e sistemit të ngrohjes (apo në kallda ose elemente përciellëse) me saldim. Përfshin identifikimin e rrjedhjes, zbrazjen e pjesës përkatëse të instalimit, saldimin, materialet ndihmëse, rimbushjen e sistemit, largimin e ajrit dhe testimin pas riparimit. Një intervenim nënkupton punën në një objekt shëndetësor gjatë një vizite, pavarësisht numrit të pikave të rrjedhjes që mund të riparohen me saldim. Këtu përfshihet edhe zëvendësimi i pjesës se gypit për aq sa është e demtuar nëse kjo është e nevojshme për evitimin e rrjedhjes.	copë	1	250	250		
			Totali:		450		



TABELA B - Pjesët rezervë

Nr.	Përshkrimi i pozicionit dhe specifikimi teknik	Njësia	Sasia		
	Rezistencë elektrike për ndezjen automatike të peletit,				
1	për kaldaja me kapacitet 30–50 kw	copë	1	50	50
2	për kaldaja me kapacitet 110–200 kw	copë	1	70	70
	Ventilator për furnizimin me ajër të djegies, me motor elektrik,				0
3	për kaldaja me kapacitet 30–50 kw	copë	1	100	100
4	për kaldaja me kapacitet 110–200 kw	copë	1	150	150
	Ventilator për nxjerrjen e tymit, me motor elektrik,				0
5	për kaldaja me kapacitet 30–50 kw	copë	1	80	80
6	për kaldaja me kapacitet 110–200 kw	copë	1	140	140
	Motor elektrik për mekanizmin e furnizimit me pelet, me fuqi dhe rrotullime sipas pajisjes ekzistuese.				0
7	për kaldaja me kapacitet 30–50 kw	copë	1	200	200
8	për kaldaja me kapacitet 110–200 kw	copë	1	300	300
	Reduktor për motorin e furnizimit me pelet, kompatibil me motorin dhe mekanizmin ekzistues.				0
9	për kaldaja me kapacitet 30–50 kw	copë	1	100	100
10	për kaldaja me kapacitet 110–200 kw	copë	1	150	150
	Pompë qarkulluese për sistemin e ngrohjes, me prurje, lartësi manometrike dhe dimensione të përshtatshme,				0
11	për kaldaja me kapacitet 30–50 kw	copë	1	150	150
12	për kaldaja me kapacitet 110–200 kw	copë	1	980	980
	Enë zgjerimi për sistemin e ngrohjes, me vëllim dhe presion pune përkatëse,				0
13	për kaldaja me kapacitet 30–50 kw	copë	1	55	55
14	për kaldaja me kapacitet 110–200 kw	copë	1	150	150
	Valvul sigurie për sistemin e ngrohjes, me presion				0
15	3/4'	copë	1	10	10
16	1'	copë	1	12	12
	Mekanizëm transportues i peletit, përfshirë vidën transportuese ose pjesën përkatëse të mekanizmit, sipas konstruksionit ekzistues.				
17	për kaldaja me kapacitet 30–50 kw	copë	1	150	150
18	për kaldaja me kapacitet 110–200 kw	copë	1	250	250
19	Sensor i temperaturës së kaldajës, kompatibil me sistemin e kontrollit ekzistues.	copë	1	25	25

EKOTERMIKA

20	Sensor i flakës për kontrollin e djegies së peletit, sipas modelit të kaldajës.	copë	1	25	25
21	Termostat sigurie kundër mbinxehjes së kaldajës, me temperaturë aktivizimi sipas specifikimit të prodhuesit	copë	1	25	25
22	Panel elektronik për komandimin dhe automatizimin e kaldajës, kompatibil me modelin dhe pajisjet ekzistuese.	copë	1	50	50
23	Ekran komandues për kaldajën, nëse është pajisje e veçantë nga paneli elektronik.	copë	1	50	50
24	Manometër për matjen e presionit të ujit në sistemin e ngrohjes, me shkallë matëse dhe lidhje të përshtatshme.	copë	1	20	20
25	Termometër për matjen e temperaturës së ujit në sistemin e ngrohjes.	copë	1	20	20
26	Siguresa elektrike automatike, me amperazh dhe karakteristika sipas qarkut elektrik përkatës.	copë	1	20	20
27	Rele elektrike për komandimin e pajisjeve të kaldajës, sipas tensionit dhe rrymës së punës.	copë	1	45	45
28	Kontaktor elektrik për komandimin e motorëve dhe pajisjeve elektrike, sipas ngarkesës përkatëse.	copë	1	56	56
29	Ndërprerës elektrik për pajisjet e sistemit të ngrohjes, sipas specifikimit ekzistues.	copë	1	20	20
30	Klema, terminale dhe konektorë elektrikë për lidhjen e pajisjeve të sistemit të ngrohjes.	set	1	1	1
31	Valvul moskthimi për sistemin e ngrohjes, me dimensione dhe presion pune sipas instalimit ekzistues.	copë	1	10	10
32	Valvul mbyllëse për instalimin e ngrohjes, me dimensione dhe presion pune sipas tubacionit ekzistues.	copë	1	10	10
33	Valvul për mbushjen dhe zbrazjen e sistemit të ngrohjes, me dimensione sipas instalimit ekzistues.	copë	1	10	10
34	Valvul automatike për largimin e ajrit nga sistemi i ngrohjes.	copë	1	10	10
35	Filtër uji për sistemin e ngrohjes, me dimensione dhe prurje sipas instalimit ekzistues.	copë	1	5	5

25%

997.25

EKOTERMIKA SH.P.K. 811034834

36	Filtër magnetik ose ndarës i papastërtive për sistemin e ngrohjes, nëse kërkohet nga instalimi ekzistues.	copë	1	5	5
37	Valvul termostatike ose e motorizuar për përzierjen dhe rregullimin e temperaturës së ujit në sistemin e ngrohjes.	copë	1	5	5
38	Valvul termike për mbrojtjen e kaldajës nga mbinxehja, kur sistemi është i pajisur me këtë lloj mbrojtjeje.	copë	1	5	5
39	Set për riparimin e pompës qarkulluese, duke përfshirë guarnicionet dhe pjesët e brendshme që mund të zëvendësohen pa ndërruar pompën komplet.	set	1	250	250
40	Fitingje, reduksione, bërryla, rakorderi dhe lidhëse për riparimin e tubacioneve të sistemit të ngrohjes.	set	1	200	200
41	Ventil hyrës në radiator	copë	1	15	15
42	Ventil dalës në radiator	copë	1	10	10
		Totali:			**3989**



TABELA C - SHËRBIMET E MONTIMIT TË KLIMAVE

Nr.	Përshkrimi i pozicionit dhe specifikimi teknik	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera		
1	Furnizimi me material përcjellës dhe montimi i klimave inverter për ngrohje dhe ftohje, me kapacitet 12,000 BTU (të reja në pako). Pozicioni përfshin montimin e njësisë së brendshme dhe të jashtme, mbajtëset metalike për njësinë e jashtme, gypat e bakrit për lidhjen e njësive me izolim termik, kabllot elektrike dhe kabllot e komunikimit, gypin për largimin e kondensimit, materialet për lidhje dhe fiksim, si dhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme për instalim, lidhje, testim dhe funksionalizim të plotë të klimave. Përfshihen edhe shpimi i mureve dhe mbyllja e hapjeve pas instalimit. Të gjitha materialet duhet të jenë të përshtatshme për pajisjet përkatëse dhe montimi të kryhet sipas udhëzimeve të prodhuesit.	copë	1	444	444	25%	111
			Totali :		444		

REKAPITULLIM

Vlera totale A+B+C	€	**4,883.00**
Vlera totale e pështuar (sipas rëndesisë) A+B+C	€	**1,333.25**

Vlera/Çmimi total i peshuar (ofertat do të vlerësohen ne bazë të kësaj vlere). Kjo është vlera e cila do te duhet të shenohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.

Në çmim të përfshihen të gjitha taksat e aplikuara në Kosovë,duke llogaritur edhe tvsh-në

Identifikim i operatorit ekonomik (OE)	
Emri i kompanisë:	EKOTERMIKA SHPK
Adresa e plotë:	Rr.Blerim Krasniqi nr.7 Bukosh Suharke
Përfaqësuar nga:	
Emri dhe mbiemri:	Arlind Krasniqi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	02.11.2026
Vula:	